



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI BASENIT UJOR ERZEN

1/5 KBU  
27.2.23

VENDIM

Nr.1, datë 09/02/2023

PËR

**MIRATIMIN E AUTORIZIMIT PËR VEPRIMTARI TË TJERA NË BRIGJET DHE SHTRATIN E BURIMIT UJOR, ME VENDNDODHJE: NË UJËMBLEDHËSIN TË XHAFZOTAJ, NJËSIA ADMINISTRATIVE RRASHBULL, QARKU DURRËS.**

Në mbështetje të pikës 2, të nenit 50, të ligjit nr.111/2012, “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”, i ndryshuar dhe të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.550, datë 15.07.2020, “Për miratimin e formularëve të kërkesës për miratimin, në parim, për dhënien me koncesion të përdorimit të burimit uhor, e lejes/autorizimit për përdorim burimi uhor, veprimtari ndërtimore në brigje, veprimtari në shtratin e burimit uhor, shkarkime të lëngshme, përdorimin dhe ripërdorimin e ujërave të përdorura, të ndotura, të dokumenteve shoqëruese, të procedurës së shqyrtimit e të vendimmarrjes dhe të afateve të vlefshmërisë së tyre”, me propozimin e Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore, Këshilli Basenit Uhor Erzen,

V E N D O S I:

1. Miratimin e autorizimit për veprimtari të tjera në brigjet dhe shtratin e burimit uhor, të Operatorit të Sistemit të Transmetimit (OST Sh.a), për ndërtimin e shtyllave Nr.8 dhe 9 në zbatim të projektit “Ndërtimi Linjës së re me dy qarqe 400/220 kV Nënstacioni i Rrashbullit–Nënstacioni Tirana 2 dhe Zgjerimi i N/St-ve ekzistuese Tirana 2 dhe Rrashbull” me vendndodhje: Në ujëmbledhësin e Xhafzotaj, Njësia Administrative Rrashbull, Qarku Durrës.
2. Të dhëna mbi veprimtarinë:

Emri Burimit Uhor: Ujëmbledhësi Xhafzotaj

Vendndodhja, ndërtimi i shtyllave Nr. 8 dhe 9 ( Koordinatat KRGJSH):

- Shtylla nr.8: X= 459646.1; Y= 4577210.0; Z= 22.2 m.m.n.d
- Shtylla nr.9: X= 459838.3; Y= 4576907.0; Z= 29.6 m.m.n.d

3. Ngarkohet Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas njoftimit të përmbajtjes së vendimit subjektivit.

**KRYETARI I KBU ERZEN**

**AFRIM QËNDRO**

